

VENDIM
Nr. 696, datë 31.7.2015

PËR TAVANET PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2016 – 2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2016 - 2018, sipas lidhjes nr. 1 “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Vendimi nr. 285, datë 1.4.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2016 - 2018”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

